



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**  
**Nr. 02-060/01-0069482-5/24 dt. 30.10.2024**  
**Mitrovicë**

02 Nr. Protokollit: 02-060/01-0069482-5/24  
Nr. Liq./Biletë: \_\_\_\_\_  
Data/Orë: 30.10.2024  
Shtetë: Mitrovicë - Mitrovica

Bazuar në Nenet 13 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, të Ligjit Nr.03-40 për Vetëqeverisje Lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenet 21, 53 paragrafi 3, të ligjit Nr. 02/L-28 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative (GZ Nr. 20 publikuar më 21 qershor 2016); nenet 13 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4, të Statutit të Komunës së Mitrovicës Jugore, Nr.02-060/01-0056607/20-4 të dt. 24.09.2020, pasi shqyrtoj Propozim Vendimin Nr. 02-0400/01-007080/24 të dt. 28.10.2024 për ndryshim dhe plotësim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-00049042-2/24 të dt. 31.07.2024 Për lejimin e mjeteve financiare nga subvencionet për familjet e prekura nga vërshimet dhe shembja e dheut në Komunën e Mitrovicës së Jugut, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30.10.2024, miratoi këtë:

### VENDIM

**Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.02-060/01-00049042-2/24 të dt. 31.07.2024 Për lejimin e mjeteve financiare nga subvencionet për familjet e prekura nga vërshimet dhe shembja e dheut në Komunën e Mitrovicës së Jugut**

1. Me këtë Vendim NDRYSHOHET dhe PLOTËSOHET Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-00049042-2/24 dt. 31.07.2024 Për lejimin e mjeteve financiare nga subvencionet për familjet e prekura nga vërshimet dhe shembja e dheut në Komunën e Mitrovicës së Jugut.
2. Sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi ndryshohet dhe plotësohet pika 3 (tre) e Vendimit Nr. 02-060/01-00049042-2/24 të dt. 31.07.2024, dhe teksti ekzistues zëvendësohet me tekstin si ne vijim:
  - 2.1 Mjetet e lejuara sipas pikës 2, të këtij vendimi në shumë prej 120,000.00 € ipen nga kategoria ekonomike Subvencione dhe transfere të Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencja dhe 40,000.00 € nga kategoria ekonomike Subvencione dhe transfere të Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm dhe paguhen në xhirollogaritë personale të të dëmtuarve sipas Listës së dëmeve në ekonomi familjare (shtëpi të dëmtuara) të evidentuara në Raportin e Komisionit të Komunës për vlerësim dhe verifikim të dëmeve Nr. 02-052/01-0006238/24 dt. 26.01.2024.
3. Pikat tjera të Vendimit mbeten të pandryshuara.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës, Drejtoria Siguri dhe Emergjencja, Drejtorisë për planifikim dhe urbanizëm dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesja e Kuvendit

Vësa BROJA

Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryesueses së Kuvendit  
1 x 1 MAPL-së  
1 x 1 Arkivit  
Kopje: Kryetarit të Komunës  
Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencja  
Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm

